



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-64013/26, më 04 MAY 2026

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L - 087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 31/15, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ANËTARES NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.

1. **Fitnete Bejta**, caktohet anëtare në komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale të Komunës së Prishtinës "Stacioni i Autobusëve" SH.A.
2. Anëtarja e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, së bashku me dy anëtarët të cilët i emëron Kuvendi i Komunës, e përbëjnë komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A.
3. Anëtarja e komisionit komunal të aksionarëve, e caktuar me këtë vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Kryeqytetit.
4. Veprimet e anëtares së komisionit komunal të aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtares;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

